



Urban Research Institute

Praktika më e Mirë e Riciklimit përmes Vullnetarizmit.

EUROPA PËR QYTETARËT

Objektivat dhe prioritetet

Qëllimi i projektit ishte jo vetëm të prezantojë standardet e EU-së mbi riciklimin, por gjithashtu të vë theksin mbi rëndësinë që vullnetarizmi ka, si dhe gjithashtu rëndësinë që ai ka mbi menaxhimin e qëndrueshëm të riciklimit.

Objektivi i përgjithshëm i projektit ishte krijimi i një bashkëpunimi ndërmjet bashkive pjesmarrëse.

Projekti ishte shumë i suksesshëm në plotësimin e objektit të përgjithshëm dhe specifik të paracaktuar.

Objektivi specifik i projektit të lidhur me rritjen e ndërgjegjësimit të studentëve duke përfshirë përfitimet e konceptit të vullnetarizmit, të cilat u arritën në mënyrë të suksesshme përmes aksionit të pastrimit në Durrës, ashtu si dhe promovimi përmes leaflets, Tv apo publikimeve në faqet e web-it.

Objektivi i përgjithshëm i projektit, i cili lidhet me krijimin e bashkëpunimit ndërmjet dy komunave mjaft të suksesshme. Komuna e Molës tashmë ka ftuar zyrtarë të Bashkisë së Durrësit për bashkëpunime në të ardhmen.

Aktivitetet

Bashkia e Durrësit, në bashkëpunim me Insitutin e Kërkimeve Urbane (IKU) ka propozuar një mbledhje lidhur me praktikën më të mirë të riciklimit përmes vullnetarizmit në rajonin e Durrësit.



Në 19 Maj një tryezë e rrumbullakët u organizua me përfaqësuesit e Bashkisë së Durrësit, përfaqësuesit e Komunës së Molës dhe stafin e IKU, të cilët u ftuan të diskutonin lidhur me qëllimet e projektit.

Metoda e përdorur ishte shkëmbimi i eksperiencës lidhur me çështjen e riciklimit dhe politikës së menaxhimit të mbetjeve.

Aktorët e përfshirë diskutuan rreth mbledhjes së mbetjeve dhe menaxhimit të mbetjeve, të zbatuar në qytetin e Molës, metodat e përdorura nga Komuna e Molës lidhur me menaxhimin e mbetjeve, etj.

Në 20 Maj u organizua aktiviteti i pastrimit dhe riciklimit përgjatë bregdetit të Durrësit.

Metoda përfshiu një masë ndërgjegjësimi për të rritur njohuritë dhe angazhimin e studentëve dhe qytetarëve në rajonin e Durrësit mbi përfitimet e riciklimit për mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin ekonomik.

Për këtë arsye një numër prej 70 studentësh, stafi i IKU-t, në bashkëpunim me 23 ekspertë të Komunës Mola dhe përfaqësues të Bashkisë së Durrësit, u angazhuan në pastrimin e bregdetit.

I gjithë aksioni i ndërmarrë u mundësua nga vullnetarizmi, i cili ishte me rëndësi për rishikimin e standardeve akyuale në kuadër të standardeve të EU-së, po ashtu si dhe rëndësia që ai ka në menaxhimin e qëndrueshëm të riciklimit.

Faktet Kryesore

PARTNERËT:

- Komuna e Molës në Bari

KOHËZGJATJA:

01/05/2014- 21/05/2014

PËRFITUESIT:

- Qarku Durrës

KONTAKTI:

Zana Vokopola
Drejtor Ekzekutiv
Insituti i Kërkimeve Urbane
Tirana, Shqipëri
Tel: +355 4 2256840

Rreth IKU

Që nga viti 1999 Instituti i Kërkimeve Urbane (IKU) ka dhënë rezultate të mëdha për projektet dhe programet e zhvillimit të realizuara në të gjithë Shqipërinë. Puna jonë ynë kryesore përqendrohet në zhvillimin e komunitetit, forcimin e qeverisjes vendore, mbrojtjen e mjedisit, decentralizimin dhe shërbimet publike. Ne kryejmë studime, llojshmëri qeverinë, trajnojmë njësitë e qeverisjes vendore, rrisim aksesin e publikut në informacion, dhe lidhim partnerët në punën për zhvillim.. IKU ka punuar me donatorë si USAID, Bashkëpunimi Zvicëran, Ambasada Holandeze, UNDP, Banka Botërore, BE, SIDA, Shoqëri të Hapur / Fondacioni Soros, etj.